

Predrag Krstiq (Predrag Krstić)
Instituti për Filozofi dhe Teori Sociale
Universiteti i Beogradit

Trajtimi intelektual i “Kosovës”: pritjet, nënshtrimet ndaj fatit dhe reaksionet serbe

Abstrakt:

Ky punim shqyrton reagimet e opinionit profesional, kulturor dhe intelektual serb ndaj ngjarjeve në Kosovë dhe lidhur me Kosovën në tri dekadat e fundit, duke u fokusuar në veçanti në periudhën e shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës. Në pjesën e parë të punimit shtrohen reagimet emotive ndaj sfidës që provokuan ngjarjet në Kosovë. Pjesa qendrore e punimit u kushtohet shpjegimeve ose racionalizimeve, të cilat pretendojnë interpretimin e tyre teorik, ku veçohen si veçanërisht karakteristike një model “gnostik” dhe një model “kritik” i të kuptuarit të “Kosovës”. Në përfundim sugjerohet që papërshkueshmëria e sistemeve diskursive rivale dhe e rrjedhave argumentuese të një konflikti tanimë a priori të përcaktuar, nuk ofron shpresë se midis tyre do të arrihet jo të paktën një pajtim, por as një dialog i përgjegjshëm.

Fjalët kyçe:

Kosova, intelektualët serbë, reagimet emotive, vizioni gnostik, të kuptuarit kritik, roli i inteligjencies.

1. Përshkrimet emocionale dhe përshkrimi i emocioneve

Kosova më 17 shkurt 2008 në mënyrë të njëanshme dhe, siç insistohej në Serbi, të kundërligjshme shpalli pavarësinë dhe po ashtu kundërligjshëm u njoh nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët e saj europianë kyç. Kjo shkaktoi një varg reagimesh dhe aktesh ku më pak e ku më shumë emocionale në opinionin e kapur në befasi në Serbi. Kreu shtetëror serb reagoi parimisht me aksione politike dhe diplomatike, të cilat e mohonin legjitimitetin e aktit të shqiptarëve të Kosovës dhe zbusnin rrezikun nga konflikte më të mëdha: ftoi serbët në Kosovë që të përmbahen nga dhuna dhe të mos shpërngulen; garantoj se të gjithë qytetarët e Kosovës, të cilët e njohin shtetin e Serbisë, do të jenë shtetas me të drejta të plota të saj; në seancën e Kuvendit të Serbisë u konfirmua vendimi i Qeverisë për anulimin e aktit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe për tërheqjen e ambasadorëve nga shtetet që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Serbia dhe Rusia kërkuan që pikërisht më 17 shkurt në mbrëmje të mbahet një mbledhje urgjente e Këshillit të Sigurimit, në të cilën do të anulohet akti i shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës.

Mirëpo, reagimi i pritur i qytetarëve në formën e mitingjeve të shumta protestuese u përmyll në mbrëmjen e 17 shkurtit me incidente serioze dhe dëmtimin e para së gjithash ambasadave amerikane dhe sllovene, pastaj u shkatërruan edhe disa sipërmarrje “perëndimore”, siç janë “McDonalds” dhe “Merkator”, si dhe një numër i dyqaneve në pronësi të shqiptarëve. Sulmi ndoshta më i rrezikshëm në aspektin politik dhe diplomatik ishte sulmi i mijëra serbëve ndaj dy vendkalimeve administrative ose kufitare, varësisht nga pikëvështrimi, me Kosovën. Të paktën dy ministra serbë i mbështetën këto aksione me deklaratat se gjuajtja me gurë e ambasadave të vendeve që e kanë njohur Kosovën është një “veprim demokratik” dhe se djegia e pikave doganore është “legjitime dhe në pajtim me politikën e Qeverisë së Serbisë” (Vučetić, 2008a). Qeveria e Serbisë ishte organizatore zyrtare e mitingut masiv protestues “Kosova është Serbi” në Beograd më 21 shkurt. Mitingu vetë kaloi pa incidente, por një grup prej një mijë “huliganësh politikë të rinj” në kohën e mbajtjes së mitingut dhe ceremonisë së lutjeve dhe menjëherë pas tyre, para ambasadave amerikane dhe gjermane, e më pas edhe para asaj sllovene, britanike, turke, belge, kroate, kanadeze dhe të Bosnjës e Hercegovinës shkaktoi incidente të rënda. Situata më dramatike qe para ambasadës amerikane, e cila jo vetëm që u shkatërrua, por edhe u dogj, ndërsa brenda saj më vonë u gjet kufoma u djegur e demonstruesit Zoran Vujoviq. Për pasojë, një panik shkatërrues e përfshiu qendrën e Beogradit, gjatë të cilit u shkatërruan dhjetëra dyqane dhe disa banka të huaja, ndërsa shumë dyqante veshjesh sportive, këpucësh, kozmetike dhe kompjuterash u plaçkitën. Prandaj, do të mund të thuhet se kur është fjala për qytetarët e Serbisë, “shpallja e njëanshme dhe e kundërligjshme e pavarësisë shtetërore të krahinës serbe, Kosovës e Metohisë”, u prit me hidhërim, nga njëra anë për shkak të “grabitjes kundërligjore dhe të dhunshme të një pjese të territorit shtetëror”, e nga ana tjetër për shkak të “ndjenjës së pafuqisë dhe të poshtërimit të shtetit dhe popullit të vet” dhe për shkak të faktit komplementar të

“triumfit dhe legalizimit të fuqisë dhe paligjshmërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare e ndërshtetërore, të cilat askujt më nuk ia garantojnë sigurinë elementare, lirinë dhe pavarësinë shtetërore” (Vučetić, 2008a; Vučetić 2008b).

Mirko Vasileviq, dekan i Fakultetit Juridik të Universitetit në Beograd, dëshmon se si nuk ka mundur të mos e marrë në konsideratë “ndjenjën se me këtë akt ishte shkelur vokacioni i profesionit tonë”: “Pa të nuk ekzistojnë kurrfarë parimesh, kurrfarë ndërgjegjeje dhe krijohet hapësirë për diktatin e fuqisë, respektivisht të më të fortit” (Vasiljević, 2008). Shpallja e pavarësisë së Kosovës në masë më të madhe u përjetua si traumë nga ata që të drejtën nuk e kanë vokacion. Mediat i gjenin jo vetëm aktorët politikë dhe ekspertët, por edhe personalitetet publike që nuk qenë ekspozuar jashtë profesionit të tyre, për t’i pyetur për “ndjenjat” që i ushqejnë lidhur me këtë ngjarje. Përgjigjet, gati pa përjashtim, ishin si të shqiptuara në divanin terapeutik dhe silleshin nga ndjenja e pafuqisë deri te dëshpërimi dhe zemërimi. Aktorja e filmit, Liljana Bllagojeviq, me rrëfimin e saj, më mirë se të tjerët i përcakton arsyet dhe thelbin e atij recepcioni dominant dhe reagimi emotiv ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës: “Kjo është aq e llahtarshme saqë njeriu paralizohet dhe e kaplon turpi për shkak të paturpësisë së të tjerëve” (Blagojević, 2008). Politikologu Zoran Stojilkoviç, si i ka hije, e përshkruan me një dozë arsyeje më të madhe shkallën e ndjenjave paralizuese me të cilat reagon këmbëza kosovare. Nënvizohet “frustrimi i madh dhe pakënaqësia me ato që nuk kemi mundur t’i bëjmë me dekada dhe të përgatitemi për një situatë që kemi mundur ta presupozojmë”, por edhe “zhgënjimi me politikën e mosrespektimit të të drejtës ndërkombëtare nga fuqitë e mëdha”, si dhe “paaftësia jonë për të bërë lëvizje optimale dhe për të mbrojtur optimumin e interesave tona” (Stojilkoviç, 2008).

Shkrimtarja dhe regjisorja Vida Ognjenoviç refuzon t’i atribuojë çfarëdo rëndësie përjetimit të saj, duke këmbëngulur në vend të kësaj te rëndësia e faktit “se shteti na ndjehet i lënduar”: “Na është bërë një padrejtësi e madhe juridike” (Ognjenović, 2008). Një shkrimtare tjetër serbe dhe e ndryshme nga e para, Liljana Habjanoviç – Gjuroviç, “lëndimit” ia shton edhe “mjerimin, disfatën dhe poshtërimin”. As si shtet, as si individë, është e mendimit ajo, megjithatë “nuk guxojmë asnjëherë ta pranojmë pavarësinë e Kosovës e Metohisë”, por duhet “të mblidhemi rreth kujtesës historike dhe besimit dhe kishës sonë”, ta “ruajmë në ndërgjegjen tonë të vërtetën dhe ta përcjellim te pasardhësit tanë, se Kosmeti është tokë serbe” – që në atë mënyrë “të mbesim zgjuar” dhe të arrijmë që “kur të vijë çasti i duhur, ta kthejmë përsëri Kosovën e Metohinë” (Habjanović-Đurović, 2008).

Mjerimi për shkak të padrejtësisë së bërë, çka është e kuptueshme, e kërkon një krye që duhet të shpallet fajtor. Shqiptarët e Kosovës në këtë sens më shumë nënkuptohen se sa emërtohen, ndërsa në plan të parë në vend të tyre theksohen “aktorët e jashtëm”. Shkrimtari Tiodor Rosiq, profesor në Fakultetin Pedagogjik në Jagodinë dhe hulumtues i përrallave popullore dhe autoriale, vlerëson se “rendi i ri botëror, i prirë nga doktrina amerikane e demokracisë totalitare, ka amputuar tokën serbe bazë, Kosovën dhe trungun tonë nacional e ka shkukur me gjithë rrënjë”: “Kosova e Metohia janë emri dhe mbiemri ynë. Të çrrënjosur, pa to jemi gjethe në agoninë

e vdekjes”. Europa, ndërkaq, “është verbëruar nga drejtësia”, nuk e ka më krenarinë degolliane dhe eurocentrizmin dhe, me përjashtim të Serbisë që ka mbetur mbase mbrojtësi i saj i fundit, “është zbrapsur nga parimet e drejtësisë, të drejtës, kulturës dhe humanizmit” dhe iu është nënshtruar interesave të “totalitarizmit ndërkombëtar amerikan”, respektivisht, sipas neologjizmit të Rosiqit, “amerizmit” (Rosic, 2008). Dobrica Eriq po ashtu e aktualizon me variacione motivin e Amerikës së keqe. E ka të vështirë t’i gjejë fjalët – “aq e padrejtë është e gjithë kjo, saqë është e vështirë ta besosh” – por është më se e sigurt se “Amerika dhe fuqitë e tjera të largqoftit mbi shpinën tonë, të serbëve, po i mashtrojnë myslimanët për të gjitha të këqijat që ua bëjnë në botë, po njëkohësisht edhe i paguajnë ata mirë” (Erić, 2008). Shkrimtari popullor dhe politikani i kohëpaskohshëm, Brana Crnçeviq, vlerëson se “ndeshja jorregullare” që Amerika e zhvillon në terrenin serb kundër Serbisë, është “gabimi më i madh i politikës amerikane dhe luftërave të tyre në mbarë historinë” (Crnčević, 2008b; Crnčević, 2008c).

Piktori Millosh Shobajiq, ndërkaq, thotë se “është jashtëzakonsht i pikëlluar, i zhgënjyer edhe më shumë, me Bashkimin European dhe politikën e tij agresive ndaj gjithçkajes që nuk është e tyre”. Për Amerikën si “grusht goditës i Europës” ai nuk do as t’ia dijë: “Mua më lebetit Europa ime, ku jam lindur dhe ku jetoj, kjo është katastrofale dhe e habitshme” (Šobajić, 2008). “E pështirë! Tmerr! Jam i shastisur”, ndërlidhet me të Petar Omçikus, po ashtu piktor dhe akademik. Edhe ai është i zhgënjyer me Bashkimin European, ndërsa për amerikanët e ka ditur se ata “okupojnë kudo ku e vënë këmbën” (Omčikus, 2008). Amplitudën e magjepsjes dhe zhgënjimit me Europën ndoshta e pasqyron më së miri historiani serb i letërsisë, profesor universiteti dhe anëtar i rregullt i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve, Niksha Stipçeviq. Sipas interpretimit të tij, “pas 2000 vjetësh Serbia dhe qytetarët e saj me besim të plotë iu kthyen Bashkimit European, edhe pse nuk mund ta harronin, as mund ta harrojnë, se aviacioni edhe i disa vendeve europiane e ka bombarduar çmendurisht për tre muaj vendin tonë më 1999, duke i privuar nga jeta disa mijëra njerëz dhe duke shkaktuar dëme materiale kolosale”. Europa, në të vërtetë, “me kërcime, në mënyrë të sinkopuar, ka vazhduar me kushtëzime që e kanë trazuar horizontin tonë politik”, ka komprometuar “vlerat europiane” dhe ka “shastisur” një vend të vetin, i cili “që nga mesjeta e hershme ishte pjesë e hapësirës europiane dhe e kulturës europiane”: “Njohja e tanishme e atij biçim shteti të Kosovës, pas mbylljes së syve ndaj përndjekjes së popullit serb, të krishterë, në territorin e Kosovës e Metohisë, është pjesë e veprimit dyfytyrësh ndaj Serbisë gjatë tetë vjetëve të fundit” (Stipčević, 2008). Edhe aktori i çmuar, Predrag Ejodus, është “sinqerisht i zhgënjyer” që “e drejta ndërkombëtare është shembur përtokë” dhe, po ashtu, “është i brengosur me raportin e pamend të Europës ndaj Serbisë dhe Kosovës e Metohisë” (Ejodus, 2008).

Armikun e “madh”, i cili i ka tradhtuar investimet miqësore të Serbisë tek ai, piktori Millorad Bata Mihailloviq e gjen tek ai “Perëndim” për të cilin serbët në luftëra “i kanë humbur dy herë nga një milion njerëz” dhe të cilin ai e quan “të mallkuar”. Duke mos besuar dot se po ndodhte diçka që i përngjan “ëndrës më të keqe”, Mihailloviq

është ende i bindur se “pas gjithë kësaj qëndron edhe kisha katolike me urrejtjen e saj ndaj Bizantit” (Mihailović, 2008a). Skenaristi Sinisha Paviq, më në fund, nuk përdor ndonjë shenjë më specifike se fjalën “bota” dhe skandalizimin me (mos)veprimin e saj e përmbledh në fjalën “turp”: “Ky është një turp i paparë dhe disfatë e plotë e të gjitha angazhimeve të Serbisë me vite – luftojmë që në vendin tonë t’i fusim vlerat që i shkelin pikërisht ata nga të cilët ne do të duhej të mësonim dhe të merrnim shembull. Kosovën po na e rrëmbejnë me forcë, me paturpësi, në mënyrë arrogante dhe fodulle, që e vë në pikëpyetje tërë sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare” (Pavić, 2008).

Piktori Millan Cile Marinković e gjen fjalën që e pasqyron humorin e tij: “e dhembshme” (Marinković, 2008). Liljana Llashiq, aktore, edhe më tej e ashpëron këtë sentiment: pohon se “gati asgjë më e dhembshme” nuk i ka ndodhur në jetë që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe, posaçërisht, për mënyrën “ashiqare të turpshme” si është bërë një gjë e tillë. As ajo nuk e lë pa e theksuar me rezignim se ashtu po dëshmohej “sa padrejtësi ka në tokë”, por në vend se për këtë arsye të ndjehet e pafuqishme, zemërimin e drejton mbi “kolonën e pestë në trajtën e organizatave joqeveritare” dhe mbi “të gjithë mercenarët që e kanë treguar fytyrën e tyre” dhe të cilët “e shesin tokën e vet” (Lašić, 2008).

1.1. Historitë personale

Edhe pse të gjitha përjetimet e cekura kanë një ton të theksuar personal, një vend të veçantë e zënë ndjenjat e atyre që me historitë e tyre jetësore kanë qenë të lidhur me Kosovën. Regjisori jugosllav dhe serb i teatrit, Lubisha Ristić, për shembull pohon: “Jam i lindur në Prishtinë. Unë kurrë Kosovën e Metohinë nuk do e përjetoj si të pavarur. Deri në fund të jetës nuk do ta pranoj që ajo nuk është në Serbi, çfarëdo që të ndodhë” (Ristić, 2008). Regjisori i famshëm, Zdravko Šotra, shpalljen e pavarësisë së Kosovës e përjeton me “hidhërim të madh” – i cili e përmban një notë vendimtare të dëshmisë personale: gjatë Luftës së Dytë Botërore si fëmijë i ka parë “vagonat e stërmbushur me serbë që janë dëbuar nga Kosova”, në kuadër të projektit të pavarësisë së saj që e “ka mbështetur Adolf Hitleri”. Me ashpërsi përfundon se “ka ardhur koha që fuqitë e mëdha të përmbushin qëllimin e askujt tjetër pos – Hitlerit. E hidhur, apo jo?” (Šotra, 2008). Piktori në zë serb, Luba Popović, nga Parisi po ashtu bën një analogji me Hitlerin: sipas pikëvështrimit të tij, harta e Serbisë çfarë e kishte planifikuar Hitleri që më 1941 nuk dallohet fare “nga ajo që është sot me vullnetin e të fuqishmëve të huaj”, të cilët “vite të tëra na bëjnë presion” dhe nën presionin e të cilëve “nuk kemi shumë mundësi zgjedhjeje”. Na mbetet, në të vërtetë, Kosova si “shpatë me dy teha: nëse e merr do pendohesh, nëse e lë do pendohesh po ashtu” (Popović, 2008).

Aktori i filmit, Lubisha Samarxhiq, Kosovën e konsideron vendlindje të vetën, sepse nëna e tij është e lindur në Prishtinë. Edhe pse thotë se me të nuk është i “lidhur me litarthin e kërthizës”, “e djeg” dhe “e trishton” “ikja” e saj (Samardžić, 2008). Radosllav Zelenović, drejtor i kinotekës jugosllave, me plot arsye është më intimisti kur bëhet fjalë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës në përgjithësi: është lindur në Mitrovicën

e Kosovës, shkollën fillore e ka kryer në Fushë Kosovë, ndërsa të mesmen në Pejë dhe Prishtinë. Duke pasur parasysh përvojën jetësore, është e kuptueshme se për të Graçanica, Deçani, Patrikana e Pejës dhe “vende të tjera të shenjta nuk janë vetëm godina, gurë mbi gurë të parëndësishëm”, por vende të “ekskursioneve të tij, kujtimeve më të bukura”, “gëzimeve të para si nxënës” dhe njohjes me miq, vende mësimi dhe provash, për të cilat mund të shtrohet pyetja prekëse nëse për dikë kurdoqoftë mund ta kenë një domethënie të tillë. E ka të vështirë t’i “kanalizojë ndjenjat” pas 17 shkurtit, por i duket se është “në depresion, i mërzhitur”. Por, edhe i tillë, gjen forcë për një vlerësim të barazpeshuar: e kundërshton “demonstrimin e dhunshëm e huliganesk” që i rrënon ambasadat nëpër Beograd, por e fyen “cinizmi i Europës dhe Shteteve të Bashkuara që ‘reklamohen’ si miqtë tanë, ndërsa na e marrin atë me të cilën na lidhin pashkëputshëm historia dhe rrënjët” (Pavićević, 2008a).

1.2. Vetë jemi fajtorë

Që në ato ditë të para pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës kishte, ndërkaq, edhe zëra disonantë, të cilët pikërendesën e fajit e zhvendosnin mbi “ne”. Sociologut dhe kulturologut të praktikës së përgjithshme, Ratko Bozhoviqit, kjo i shërbeu për të vënë në pah se raporti serb ndaj Kosovës bazohet në “perceptimin jo të saktë të realitetit dhe është fryt i mentalitetit tonë që ta ndrydhim të vërtetën dhe ta shtyjme tutje kur bëhet fjalë për të kuptuarit e vetes dhe të tjerëve”: vetë Kosova është shembull shkollor i një teme tabu shumëvjeçare që e kanë zgjidhur elitat politike, në vend se të jetë objekt i debatit të njëmendtë publik midis ekspertësh. Regjisori Zdravko Šotra ishte edhe më i drejtpërdrejtë: serbët me çështjen e vet nacionale dhe interesat nacionale shumë gjatë po merren në “mënyrë diletante” dhe për këtë arsye bien në vështirësi (Anonim, 2008b). Kompozitori, pianisti dhe orkestruesi i muzikës, Kornelije Kovač, po ashtu konstaton se “ne e pësojmë për shkak të politikës së gabuar në të kaluarën” dhe na mbetet “që sall të luftojmë që serbëve, të cilët do të vazhdojnë të jetojnë në Kosmet, t’u sigurojmë një jetë normale dhe dinjitoze”. “Natyrisht që nuk është e drejtë”, do të shtojë ai me trishtim, “por kam përshtypjen se tani është vonë për gjithçka” (Kovač, 2008)

Branko D. Kovačević, akademik dhe në kohën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës rektor i Universitetit të Beogradit, po ashtu është i mendimit se ajo është “pasoje e politikës së udhëhequr keq gjatë dekadës së fundit të shekullit të kaluar”. “Ishte luftë dhe ne e kemi humbur atë luftë. Kur e humb luftën, e humb edhe një pjesë të territorit”. Nga ky qëndrim “realist”, ndërkaq, ai kalon shpejt e shpejt te kontrapunkti i tij dhe siguron që një humbje të tillë të territorit askush nuk mund ta nënshkruajë, se “Serbia nuk do të heqë dorë nga cilado pjesë e tokës së saj” dhe se “duhet të luftojë me të gjitha mjetet legale për ta mbrojtur popullin e vet, shkollat dhe ekonominë e tij”. Në këtë dyzim, ai pranon: “Ndjehem keq, mbase si të gjithë” (Kovačević, 2008). Vasilije Krestiq, historian dhe akademik, me anë të përemrave i bën bisht emërtimit “të asaj që po ndodh”. “Kjo”, ndërkaq, sigurisht që e “çmend”, është i pikëlluar, “i

mjerë dhe i turpëruar” dhe, mbi të gjitha, “i shastisur nga primitivizmi arrogant pas të cilit qëndron forca”. Megjithatë, ai shpreson se “nga e gjithë kjo do të gjejmë një rrugëdalje racionale”, por edhe ushqen frikën apokaliptike se “ky është fillimi i një krize ndërkombëtare më të thellë” (Krestić, 2008).

Kompozitori Zoran Hristić, me analogji muzikore e godet mirë po atë ndjenjë të mungesës së rrugëdaljes, më shumë paradoksale se tragjike: “Duke mos i respektuar ligjet e veta të harmonisë, mbi të cilat bazohet shoqëria në zgjidhjen e problemeve emergjente, jemi futur në disharmoninë e botës, në forcën si masë e vetme e më të fortëve. Jemi bërë një vend disharmonik i kujës, vrasjeve, mjerimit, kriminalitetit, vetëshkatërrimit dhe politikanëve të ndarë me paravanin kosovar dhe dhomën e shurdhër, në të cilën nuk dëgjohet ankimi i popullit që jeton keq”, një vend “elita intelektuale e të cilit i çmend dhe i huton serbët me retorikën plot patos për Kosovën” dhe me “autizmin nationalist fatal” Serbinë gjithnjë e më shumë po e “ndan nga bota”: “jemi familjarizuar me tragjeditë që na kanë goditur. Të pafuqishëm e grishim Zotin, bëjmë mitingje për rrënimin tonë dhe në rrënimin tonë” (Hristić, 2008).

2. Kosova si fatum: gnosticizmi serb

Nga konceptualizimet e artikuluara pak a shumë teorikisht (dhe jo vetëm emocionalisht) të statusit aktual të Kosovës, fillimisht do të mund ose do të duhej t'i kushtohet vëmendje pikërisht asaj “retorike plot patos të autizmit nationalist fatal”, një, thënë në mënyrë më neutrale, diskursit epik serb, motiv bosht i të cilit është Kosova dhe i cili u rivitalizua dhe sprovua me një fuqi të re me rastin e shënimit të gjashtëqind vjetorit të Betejës së Kosovës. Poeti dhe akademiku Matija Bećković, trashëgimtari më mbresëlënës i asaj tradite dhe kënge popullore, në vitin 1989 mbajti një ligjëratë në qendrat nacionale dhe institucionet kishtarë-shkollore fillimisht në Australi, pastaj në Europën Perëndimore dhe më në fund në Jugosllavi, për t'a botuar po atë vit në *Književne novine* dhe *Glas crkve*. Titulli i saj do të bëhet menjëherë parullë e betimit për ruajtjen e Kosovës: “Kosova – fjala më e shtrenjtë serbe”, e aty, që në fillim, është e qartë çfarë vlere ka zari: “për fatet e popullit serb asgjë nuk është më vendimtare se beteja në Kosovë dhe për Kosovën” (Bećković, 1989).

Si “ekuator i planetit serb”, “kulm i botës së poshtme dhe themel i botës së epërme”, “Ungjill serb”, Kosova për serbët është edhe shenjë njohjeje dhe përkatësie. Ajo përfaqëson “vatrën rreth së cilës është mbledhur, skeletin rreth të cilit është ngjitur, djepin në të cilin është rritur populli serb”, “plagën më të thellë, kujtesën më të gjatë, kujtimin më të gjallë, hirin më të dashur të popullit serb”, për ç'arsye ai nuk mund të ketë “asgjë të krahasueshme me Kosovën, as në historinë e vet, as në gjeografinë e vet”, kurrfarë “pikëmbështetjeje më të fortë, as qendër shpirtërore më të fuqishme”, prandaj serb është vetëm “ai të cilit i intereson Kosova” (Bećković, 1989).

Kosova është, thënë shkurt, “gjithandej ku ka serbë” dhe për këtë arsye humbja e saj sot do të ishte “disfata më e rëndë, tronditja më e thellë, një thyerje më e madhe në vetëdijen e serbëve se ajo e vitit 1389”. Po ta humbisnim tani Kosovën, e cila është e

“yjesuar me monumente kulturore serbe, manastire e kisha, me vende të shenjta dhe varreza” – “vetëm do ta dëshmonim se jemi pinjor të atyre që kanë tradhtuar atje që në vitin 1389”. Tradhtia e Kosovës, ku është “varrosur i gjithë populli serb”, do të ishte edhe dorëzim i tij, sepse serbët “me atë tokë nuk mund të bëjnë tregti” (Ibid.).

Po atë vit, më 1989, në Gazimestan u organizua festimi masiv qendror i gjashtëqindvejtorit të Betejës së Kosovës, në të cilin foli Sllobodan Millosheviq. Matija Beqković vlerësoi se “solemniteti në Gazimestan ishte kulminacion i rebelimit nacional serb” dhe përsëriti se “Kosova është ekuator i planetit serb”, për ç’arsye është e domosdoshme të theksohet përsëri dhe gjithmonë se ajo është Serbi dhe që “ky fakt nuk varet as nga nataliteti shqiptar, as nga mortaliteti serb”, por nga sasia e “gjakut serb dhe shenjtërive serbe”, ka sosh atje aq shumë saqë “ajo do të jetë serbe edhe kur atje të mos mbetet asnjë serb”. Një vizion të ngjashëm të gjakut sakral e ka ofruar edhe poeti serb Gojko Gjogo: “Që nga Kosova e deri sot serbët nuk kanë patur një shenjtëri më të madhe se Kosovën. Ata kësaj shenjtërie i janë përkushtuar me testament dhe, ja, që gjashtë shekuj i blatojnë theroritë më të shtrenjta, flijimet në gjak. Nuk e di deri kur dhe si do t’ia bëjmë, por e di se jemi të detyruar. Sepse shteti serb pa Kosovën do të ishte njësoj si serbi me një vrimë në krahëror” (Anonim, 1999).

Pesëmbëdhjetë vjet më vonë, pas betejash të furishme dhe intervenimit të NATO-s, mu pasi u vendos njëfarë rendi nën mbikëqyrjen ndërkombëtare, në Kosovë shpërthyen përsëri “konflikte etnike” përmasash më të mëdha, të shkaktuara nga mbytja në lumë e tre djemve shqiptarë që nuk u sqarua kurrë. Asohere u sulmuan të gjitha territoret e banuara me serbë, njerëzit në to, si dhe të mirat materiale e kulturore, po edhe forcat e KFOR-it që i mbronin. Dënimi i sulmeve të shqiptarëve të Kosovës ishte i njëzëshëm në opinionin intelektual serb, por intonimi i rëndësisë së sulmeve që i ndryshëm. Beqković në tribunën e Qendrës Kulturore Serbe “Shën Sava” në Suboticë shprehu shpresën se ky “kandili më i madh që e ka parë bota moderne” – ai “hiri më i shtrenjtë që u shfaq në shekullin njëzet e një” – ndoshta do të arrijë t’ia “hapë sytë”, “edhe pse dëshmitarët e tyre që tri vjet në Kosovë i mbyllin sytë para zjarrit në të cilin po zhduken vendet e shenjta serbe” dhe edhe pse ne edhe më tutje “ndjehemi më mirë si viktimë” se sa të “notojmë në gjakun dhe fatkeqësinë e huaj” (Anonim, 2004a; Anonim, 2004b). Nëpërmjet po të njëjtit prizëm të mitologjisë serbe të Kosovës dhe të paktën në një mënyrë po aq përfaqësuese, profesori i Fakultetit Juridik në Beograd, Kosta Çavoshki, megjithatë, ka më shumë besim te fuqia e popullit të vet. Meqenëse miti i Kosovës është një nga themelet e identitetit nacional serb dhe se “pa Kosovën e Metohinë vështirë se do të mund të mbijetonim si serbë, nëse do të mund të mbijetonim fare si popull”, tani si edhe gjithmonë, “Kosova e Metohia duhet mbrojtur” (Anonim, 2004c).

Mirëpo diskursi epik i apologjisë së trishtuar të drejtësisë më në fund e merr mbështjellësin gnostik më 2008, kur Kosova shpall pavarësinë. Disfata bëhet tani garanci e ngjitjes së re në qiell dhe e shëlbimit. “Dhe kur diçka humbet (nëse humbet), është me rëndësi mënyra si humbet”, tërheq vërejtjen shkrintari i kurorëzuar Dragosllav Mihailloviq. Nëse edhe e kemi humbur Kosovën – “është me rëndësi që të mos humbasim si humbës”. Të humbasësh si humbës, siç bëhet e qartë nga teksti i

mëtejshëm, do të thotë të dorëzohesh që më parë dhe, në atë mënyrë, “të humbasësh gjithçka”. Strategjia edhe në disfatë duhet të jetë tjetërfare: “Vetëm ata që humbasin me rezistencë ndaj më të fortëve dhe në betejë me ta, nëse bien edhe kur humbasin, do të dinë një ditë të ngrihen dhe të fitojnë pastaj”. Momenti është “i tmerrshëm”, është e dyshimtë nëse do arrijmë të mbrohemi – “por, është me rëndësi të mbrohemi” (Mihailović, 2008b). Një fuqi të ngjashme të disfatës e grish edhe Svetllana Vellmar-Janković, shkrimtare dhe akademike. Ajo konstaton se pas padrejtësish të mëdha gjatë shekullit 20, më në fund kemi “kapitulluar” dhe e kemi humbur Kosovën që në çastin kur lejuam që “përkujdesjen” për të “ta marrin mbi vete forcat e organizatës ndërkombëtare që na ka bombarduar”. Kjo rënie, me të cilën pajtohet në shikim të parë, shndërrohet ndërkaq përnjëhersh në mundësi për shëlbim: “Por, meqenëse besoj në fuqinë e disfatës si një nxitje, si ftesë për urti, për shkathtësinë e alternuar të durimit dhe kundërvënies, për rezistencë të pathyeshme gandiane ndaj dhunës – jam e prirur të besoj se kjo disfatë që për ne e domosdoshme për t’u ballafaquar me veten tonë” (Velmar-Janković, 2008).

Kjo dialektikë soteriologjike është edhe më e theksuar në receptimin e akademik Dragan Nedelković. Ai vë re se “ky nuk është vetëm një çast historik i rëndë, por edhe sublim, që të përshkohemi me virtyte, të fisnikërohemi me spiritualitet, të hedhim poshtë gjithçka që na ndan dhe na poshtëron”. Gjendja është “tragjike, si pas disfatës në Kosovë në vitin 1389 dhe pas shpërnguljeve të mëdha nën patriarkët, ..., po edhe mortaja e bardhë po na asgjëson”, por nuk guxon të ketë pajtim me humbjen më të madhe: “Të armatosur me vlerat shpirtërore, morale e kulturore, ne nuk jemi dhe nuk guxojmë të jemi pesimistë”. Më e rëndësishmja është “gjendja religjioze e popullit serb”, që do të thotë, “shkalla e unitetit popullor, lartësia e dashurisë së ndërsjellë, forca e solidaritetit, forca e bashkimit”, sepse “populli që i ka ato cilësi edhe në disfatë është i pathyeshëm, moralisht dhe shpirtërisht është i pamposhtur”. Përgjithësisht, “shtegu i shndërrimit” është “i thepisur, por shpëtimtar”, ndërsa ne për shkak të shëlbimit “duhet të shndërrohemi, sepse janë këto ditë të këqija” (Milosavljević, 2008).

Kështu, dita e shpalljes së pavarësisë së Kosovës shndërrohet gati në një datë mitike, në një mitologji baza e së cilës është martirizimi i shenjtë i të drejtëve kundër forcës dhe padrejtësisë. Sipas të gjitha gjasash, deklaratën më dramatike në këtë sens e ka dhënë poeti dhe kryetari i Shoqatës së Shkrimtarëve të Serbisë, Sloboda Rakitić. Ai 17 shkurtin e vitit 2008 e ka përjetuar “si ditën më të pikëlluar pas vitit 1389”. Rakitićin në këtë “fatkeqësi të madhe” megjithatë e mban besimi te karakteri i jashtëzakonshëm i serbëve, të cilët “në çastet më të vështira tregojnë forcën, këmbënguljen, fuqinë, vendosmërinë dhe solidaritetin e ndërsjellë”, prandaj shpreson se populli “do t’i kthehet vetvetes” dhe “do të rezistojë në luftën e tij të drejtë – ta çlirojë Kosovën e Metohinë e okupuar” (Rakitić, 2008). Shkrimtari Pero Zubac tonin gati të lartësuar predikues e ngjyros me pasazhe bindëse lirike: “Të dish t’i bësh ballë padrejtësisë neve na është përcaktuar si fat gjatë kohës. Të shikosh përpara dhe me punë e dashuri ta fuqizosh vendin tënd për të bërë ballë, që të mos sëmuremi nga pikëllimi e dëshpërimi, t’i ngjeshim radhët, me shpresë se drejtësia është e përjetshme, ndërsa padrejtësia e

përkohshme” (Zubac, 2008). Edhe poeti për fëmijë Lubivoje Rshumoviq ka më shumë besim në drejtësinë hyjnore se në atë njerëzore: “Ajo që është rrëmbyer me forcën njerëzore, do të kthehet me forcën hyjnore. Unë tani nuk i di rrugët e forcës hyjnore, por besoj se Zoti do të na lajmërojë nëse do i duhet ndihma jonë” (Ršumović, 2008).

Dramaturgu, shkrimtari dhe për një kohë deputeti i popullit, Sinisha Kovačević, mbron “tezën që ka të bëjë me thelbin e ekzistencës së Kosovës të gjithë ne”: “Kosova është “vendlindja” – “fillesa e parë dhe shkaku i parë” i të gjithë neve – “pa marrë parasysh nëse jemi me prejardhje nga Sombori, Rogatica, Nikshiqi...” Ajo, në këtë etnogenealogji, njihet si i fundit “domicil i gjuhës, religjionit, traditës sonë”, vend i krijimit dhe e gjithë asaj që ne jemi, “afresk që ma përkujton prejardhjen”, “shteti nënshtetas i të cilit jam, gjuha me të cilën flas, kultura që sot e trashëgoj”, diçka shumë më tepër se ato katërmbëdhjetë për qind e territorit që mbase do ta jepnim të fundit. Duke patur parasysh pozitën e tillë parake në simbolikën mentale serbe, nuk mund të jetë ndryshe, por me shpalljen e pavarësisë së Kosovës nga Serbia, jemi “në fillim të krijimit të mitit të ri të Kosovës”: njësoj siç gjeneratat e mëparshme “për fat të keq i kanë jetuar mitologjemat e veta”, ashtu edhe të rejat “do të zhvillojnë me kujdes mitologjemën e vet duke imagjinuar për kthimin në Kosovë”. Nëpërmjet këtij “frustrimi të ri dhe shijes së re të poshtërimit të hidhur”, ajo “përsëri do të zgjatet në një kohëzgjatje mitike, e cila Kosovën përgjithmonë do ta lidhë me Serbët” (Bezbradica, 2008).

Edhe politikologu, sociologu dhe analisti politik, Slobodan Antoniq, duke mos harruar që t’i mbështesë “institucionet zyrtare në qëndrimin se pavarësia e Kosovës dhe e Metohisë është një akt i kundërligjshëm”¹⁹⁶, këmbëngul se “Kosovën e Metohinë duhet t’i ruajmë në zemrat dhe shpirtrat tanë, nëse duam ta ruajmë vetveten” (Antonić, 2008). Brana Crnčević është i brengosur për më shumë se për një kujtesë brezi dhe më me dëshirë do t’ua linte testament brezave që vijnë: ai pyet veten si të “vazhdohet jeta e kombit serb të rrezikuar?”, si t’u përcillen dhe shpjegohen “ngjarjet” “fëmijëve dhe fëmijëve të tyre”, çfarë e “vërtete në librat shkollorë zyrtarë të historisë t’u ofrohet gjeneratave të votuesve të ardhshëm?” “Gënjeshtër, sipas së cilës Amerika ka vendosur rend në Ballkanin e çmendur, le të shënohet në historinë amerikane, në historinë serbe nuk ka vend për një rrenë të tillë... Kopertinat e librit të historisë serbe nuk do të

¹⁹⁶ Mbështetja për pushtetin mund ta shpagojë me vonesë ndërgjegjen e vuarë. “Tepër i pikëlluar” për arsye se “prej nesh kërkohet të pranojmë se jemi fajtorë për të gjitha krimet që kanë ndodhur që nga shpërbërja e Jugosllavisë. Zoran Qiriq, poeti çapkën bashkëkohor dhe prozatori nga Nishi, i dënon të “ashtuquajturit demokratë serbë dhe tajkunët serbë”, të cilët kanë qenë “aktorë tepër të rëndësishëm episodikë” në një “lojë të pistë” dhe madhëron pushtetin e mëparshëm: “Dhjetë vjet kam sharë dhe mallkuar Slobodan Millosheviqin, ndërsa tani them se ka ardhur çasti ta rehabilitojmë atë personalitet historik. Historia e ka dëshmuar madhësinë e tij edhe krahas të gjitha të metave që u kanë kushtuar serbëve. Gjithë çka ka thënë Millosheviq lidhur me raportin e Perëndimit ndaj Serbisë, ishte një e vërtetë e ditur” (Ćirić, 2008). Në gjysmë të rrugës deri te një përfundim i tillë i mendjes së vonuar, por asesi i parashtruar gjer në fund, gjendet edhe mendimi i psikologut Zharko Trebješhanin mbi pritjet e tradhtuara, “humbjen dhe traumën”, për shkak të shpalljes së pavarësisë së Kosovës: “Me t’u realizuar ndryshimet demokratike, është pritur që Kosova do të kthehet nën sovranitetin e Serbisë. Tani janë propozur ato shpresa – po të kishte qenë ky dënim i një regjimi, e jo i një shteti dhe populli. Jam zhgënjyer seriozisht” (Trebješhanin, 2008).

mbyllen derisa të mos shkruhet e vërteta se Kosova është rrëmbyer dhe se Serbia nuk ka pranuar që pa faj të jetë fajtoare” (Crnčević, 2008a). Toma Fila, avokati serb i njohur si mbrojtës i politikanëve të akuzuar për veprat më të rënda kriminale, është edhe më i drejtpërdrejtë dhe më operativ kur sugjeron që, para gjithë të tjerëve, Ministria e arsimit tani duhet të merret me krizën, në mënyrë që “secilit fëmijë t’ia rrënjosë që gjatë jetës së vet ta kthejë Kosovën, nëse babai i tij nuk ka mundur ta bëjë një gjë të tillë”: “Në këtë mënyrë miti mbi Kosovën do të këndellet dhe do të jetojë te të gjithë njerëzit” (Fila, 2008).

Nëse vërtet bëhet fjalë për një mit. Mile Saviq, profesor i filozofisë në Fakultetin e Mësuesisë në Beograd dhe, në atë kohë, këshilltar i kryeministrit Vojislav Koshtunica, siguron se “Kosova nuk është kurrfarë miti, por realitet historik, i cili e ka tragjikën e vet dhe një thellësi dhe sublimitet kolosal simbolik e shpirtëror”. Saviqi është po ashtu i bindur se ne na “është bërë një padrejtësi” që na obligon të kundërvihemi, ndërsa dimensionet juridik, politik e moral është në atë masë në anën tonë kundër “qëndrimin amoral, cinik dhe paturopësisht arrogant” të Perëndimit sa na “jep forcë të qëndrojmë” dhe, sipas “urdhërit të detyrës dhe ndërgjegjes”, “të mbrojmë lirinë dhe dinjitetin” (Eraković, 2008). Edhe shkrimtari Srba Ignjatović e jep në variacione të njëjtin refren me një fund didaktik: “për ne, për popullin serb, është me rëndësi ai miti i hedhur poshtë i Kosovës, i përgojuar, i mohuar me mendjemadhësi dhe zotnillëk të rrejshëm. Na porosisin që ta harrojmë, që të heqim dorë prej tij. Që ashtu, bashkë me të, ta falim Kosovën e Metohinë. Të turpërohemi prej tij dhe ta këmbejmë me të mbeturat dhe grimcat e qytetërimit teknologjik”. Kjo është absurde, na siguron Ignjatović, njësoj sikur grekët të turpëroheshin dhe të hiqnin dorë nga Homeri, italianët nga Virgjili, ndërsa anglezët nga Shekspiri. Prandaj na ka “rastisur fatumi” që ta ruajmë Kosovën e Metohinë tonë – “kartën” tonë, “fytirën” tonë - “sepse ashtu e ruajmë veten tonë” (Ignjatović, 2008).

3. Fronti i dyfishtë i intelektualëve kritikë

Ata që zakonisht nënkuptoheshin me “intelektualë të pavarur”, alarmuesit e vetmuar dhe jo të preferuar në skenën e politikës së brendshme, pothuaj natyrshëm në reagimet e veta ndaj ngjarjeve të vitit 2008 pikësëpari kanë dënuar kundërvajtësit në radhët e kombit të vet.

Latinka Perović, historiane dhe ish-politikane, në një tribunë në Novi Sad dhjetë ditë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës vlerësoi se në vepër është një përpjekje e re e “nacionalistëve për ta imponuar konceptin e tejkaluar të shekullit 19 të shtetit të madh etnik dhe ta izolojnë Serbinë nga bota”: “Serbia sa më parë duhet të dalë nga bllokada e imponuar në të cilën ka ndodhur edhe një dhunë e tillë në Beograd që e ka shastisur botën. Linçimi verbal, dëshmitarë të të cilit jemi këto ditë, mund të shndërrohet fare lehtë në linçim të njëmendtë të jobashkëmendimtarëve politikë”. Sociologu i politikës, Jovo Bakiq, po me atë rast ka shpjeguar se terrenin për një zhvillim të tillë të ngjarjeve e kanë përgatitur “ideologë të caktuar të marrë me qira nga

DSS¹⁹⁷ dhe mediat e afërta me atë parti – duke e imponuar pandalshëm problemin e Kosovës si të vetmin problem që e ka Serbia: “Ata kanë përsëritur vargun e një poeti se Kosova është fjala serbe më e shtrenjtë, ndonëse ka edhe të tillë që mendojnë se Srebrenica është fjala serbe më e shtrenjtë” (Anonim, 2008a).

Në një tekst autorial, dramaturgia, kolumnistja dhe drejtoresha e Qendrës për Dekontaminimin Kulturor, Borka Paviqeviq, vë re se në vend të “mjerimit dhe dhunës së hordhive të të pakënaqurve” – “ka mundur të ketë pikëllim”. Asgjë, ndërkaq, nga e gjithë kjo: edhe ky rast (fatkeqësi) është shfrytëzuar “për të dëshmuar se, gjithmonë, kemi pasur të drejtë”, që “të kërcënohet çdo mendim disonant jo lidhur me çështjen e integritetit të shtetit, por lidhur me çështjen e pajtimit ose mospajtimit me politikën që e ka udhëhequr shtetin”, që në vend të tragjedisë, e cila nxit “dinjitetin, përqendrimin, përgjegjësinë, organizimin, fokusimin dhe, madje, asketizmin”, të grishen përsëri “narracioni, rrëfimi, predikimi” dhe para së gjithash “kërcënimet”, “përhapja e frikës, censurës dhe autocensurës”, të gjitha ato sipërmarrje plotësisht disfunktionale duke patur parasysh “atë që këtij mjedisi i është dhënë për ta zgjidhur”: “ballafaqimi real me identitetin dhe integritetin e qytetarëve” (Pavićević, 2008b). Ratko Bozhoviq vlerësonte se demonstratat dhe dhuna në rrugët e Beogradit kanë një dorëshkrim të njohur të atyre që “dëshirojnë ta rrëzojnë rendin demokratik dhe që Serbinë ta kthejnë në vitet 90 të shekullit të kaluar”, mirëpo tani është veçanërisht e rrezikshme që trazirat janë bërë “pjesë e politikës shtetërore”: “Nuk është fare e patëkeq që kundërvajtësit që demonstrojnë nëpër qytetet e Serbisë këto ditë i gëzojnë simpatitë e një pjese të pushtetit, si dhe të opozitës”. Ai imazh i fytyrës së shëmtuar të Serbisë iracionale të hakmarrjes e shkatërrimit, ato trazira të dirigjuara dhe të orientuara mbi caqet e përzgjedhura me kujdes gjatë mitingut “Kosova është Serbi”, të cilat askush nuk qe i interesuar t’i parandalonte, “dëshmojnë se sot e këtu është dominant narracioni antieuropian, antidemokratik dhe anticivilizues” (Savić, 2008a).

Mikllosh Biro, profesor i psikologjisë në Universitetin e Novi Sadit, konsideron se demonstratat nëpër qytetet e Serbisë pa mëdyshje tregojnë se “çështja e Kosovës është sforcuar si problem nacional dhe detyrë nacionale numër një, e pastaj kjo çështje është shfrytëzuar për homogjenizimin nacional tepër të ngjashëm me atë që e kemi parë gjatë viteve 90”. Ai përkujton se, sipas rezultateve të hulumtimit të opinionit publik, para një viti e gjysmë, “Kosova pothuajse ishte harruar”: “Njerëzit, në pjesën më të madhe të tyre, ishin të vetëdijshëm se ajo është e humbur në luftë me paktin NATO në vitin 1999. Pastaj ka filluar fushata për “ruajtjen e saj brenda kufijve të Serbisë” dhe përsëri dhe gradualisht ka filluar që në sytë e qytetarëve të Serbisë të përjetohet si qëllim më i rëndësishëm se qëllimet tjera”. “Politikanët dinakë”, sipas këtij rikonstruksioni, shpalljen dhe njohjen e pavarësisë së Kosovës e kanë paraqitur si “humbje mbi të gjitha humbjet”, si “rreëmbim të pesëmbëdhjetë për qind të territorit, si padrejtësi mbi të gjitha padrejtësitë” dhe që qe e kuptueshme të shkaktojë zemërim dhe zhgënjim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin European, pastaj

¹⁹⁷ Demokratska Stranka Srbije (Partia Demokratike e Serbisë), ishte asokohe partii në pozitë, ndërkohë që themeluesi i saj, Vojislav Koshtunica, ishte kryeministër (shën i red.)

frustrimin dhe, më në fund, agresionin. Nga ai “homogjenizim nacional i sforcuar në ‘mbrojtje’ nga padrejtësia, i përcjellë me prodhimin ksenofob të armiqve që na bëjnë padrejtësi, krahas Radiotelevizionit të Serbisë, i cili ditë me radhë transmeton filma lufte dhe partizanësh dhe policisë që lejon djegien e ambasadave të huaja”, Bironë e “kaplon rrënjëthja”, sepse tek ato ai e vë re “përgatitjen psikologjike klasike për luftë”. Secesioni i Kosovës si një e “padrejtë vërtet e bërë” ka mundur që opinionit t’i paraqitej edhe ndryshe për ta “qetësuar opinionin e vet publik dhe për ta zbutur hidhërimin e humbjes”.¹⁹⁸

4. Epilog, tani për tani

Nuk është kurrfarë risie historike, zgjat të paktën dy shekuj e gjysmë, që intelektualët t’i akuzojnë intelektualët (e tjerë) për shkak të politikës (së tyre). Aq më pak përbën risi edhe pjesa obligative e programit që intelektualët t’i kritikojnë politikanët për politikën e tyre. Mirëpo, është fenomen relativisht i freskët dhe specifik që politikanët t’i kritikojnë intelektualët për mosveprimin e tyre publik. Të gjitha kritikët janë në lojë në Serbi.

Më 2010, Nebojsa Rangjelloviq, nënkryetari i atëhershëm i Partisë Liberal-demokratike dhe profesor i Fakultetit Juridik në Nish, duket në të dy cilësitë, e fton “elitin intelektualë” në përgjegjësi për shkak të “shoqërisë në krizë”. Ai, në manierën e të kuptuarit tashmë klasik (francez) të intelektualëve, konsideron se është obligim dhe mision i tyre që me këmbëngulje t’ia shpallin shoqërisë të vërtetat e pakëndshme dhe ta “çlirojnë nga gënjeshtret e sheqerosura që demagogët mikroborgjezë i shtrijnë mbi baltën epike të historisë së zbukuruar”. Dositej Obradoviç, në betejën për iluminimin e popullit të vet analfabet, dikur ka ditur që t’i kundërvijë “kishës së gjithëpushtetshme”, ndërsa Vuk Karaxhiqi “sunduesve të vet, bashkëkombasve të paarsimuar, censurës austriake”, prandaj as intelektualët e sotëm serbë nuk kanë të drejtë që në heshtje “të shikojnë se si shoqëria e tyre po shkon në theqafje, duke mbetur robe e gënjeshtave epike dhe mentalitetit provincialist të interesave të imëta të çastit aktual politik”. Sado që të konsiderohet “shoqërisht e rrezikshme”, tani duhet thënë të vërtetat mbi Kosovën: “Në gati dy mijëvjeçarë të gjallimit sllav në këto hapësira, Kosova e Metohia kanë qenë pjesë e Serbisë për rreth dyqind vjet në mesjetë dhe disa vite (1912-1915 në shtetin bashkëkohor serb); “Që nga Shpërngulja e Madhe serbët nuk janë më shumicë etnike në ato vise”; “midis shtetit mesjetar serb dhe atij modern

¹⁹⁸ Ka qenë e mundur të flitet, thekson Biro, rreth të dhënave mbi projeksionet demografike që thonë se “me kusht që Kosova të mbetet në Serbi, shqiptarët do të bëheshin popullatë shumicë në Serbi që në vitin 2021”, se “me hyrjen e Serbisë dhe të Kosovës në Bashkimin Europian çështja e kufijve dhe e territorit bëhet plotësisht e pakuptimtë, ashtu siç e ka pakuptimësuar edhe konflikti në Irlandën e Veriut”, se Bashkimi Europian, me të cilin në mënyrë kontraproduktive nxitet konflikti, “i dërgon trupat e veta në Kosovë pikërisht për t’i mbrojtur serbët në Kosovë nga shqiptarët e ‘këqij’”, se papunësia në Kosovë është më e lartë se 70% dhe se ajo është një “vrimë pa fund”, e cila do ta kthente mbrapa ekonominë serbe”. Në vend të kësaj, flitej vetëm për territorin – për humbjen e territorit “në të cilin jeton nëntëdhjetë e pesë për qind populli shqiptarë” – dhe manipulohet posaçërisht “me njerëzit e rinj që janë të prirur për reagime të vullshme emocionale ndaj padrejtësisë” (Savić, 2008b).

nuk ekziston një kontinuitet dhe krijimi i shtetit modern nuk mund të vendoset në atë kontekst”; ndërsa “politika e gjakut dhe e trollit i shpie serbët drejt e në humnerë”. (Randelović, 2010).

Më anë tjetër, intelektualëve serbë u vjen edhe një ftesë. Më 2012, në cilësinë e presidentit të sapozgjedhur të Serbisë, Tomislav Nikoliq në kremtimin e ditës së Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve u drejtohet intelektualëve dhe e paralajmëron rolin e tyre: “Së shpejti do ju lus që të këshillohemi si ta shpiem shtetin dhe popullin nëpër një rën nga sprovat më të mëdha që na presin, e ajo është zgjidhja e fatit të Kosovës e Metohisë”. Është e kuptueshme, ai nuk i sheh si mendimtarë të pavarur që popullit ia thonë të vërtetat e pakëndshme, por si “patriotë serbë të shquar, të mençur dhe të përgjegjshëm, të cilët mund t’i kuptojnë shkaqet dhe pasojat” dhe, duke konsideruar se në një mënyrë kuvendare i “duhen Kosovës”, i fton në mobilizim: “Përgatituni. Serbisë i nevojitet që të jeni unikë, që të bashkuar t’i përdorni dijen dhe përvojën tuaj, që ta keni parasysh interesin më të rëndësishëm se atë personal dhe që reputacionin tuaj ta vini në shërbim të vendit” (Nikolić, 2012). Paralajmërimi mbase është ende në fuqi.

Nënshkrimet e Marrëveshjes së Brukselit, që po zgjasin që nga 19 prilli i vitit 2013 e deri sot, në këtë pikëpamje nuk ndryshojnë asgjë; pikërisht e kundërta, do të mund të thuhet. Që me arritjen e saj të parë, Slobodan Antoniq, ndër të tjerët, pohon se ajo zë vend “seriozisht jashtë kornizës së Kushtetutës” dhe se shtrohet pyetja nëse Kushtetuta në përgjithësi “mund ta durojë një ndërhyrje të një lloji të tillë, siç iu bë me marrëveshjen”. Në këtë kuptim Marrëveshja do të mund të bëhet një “burim i përhershëm i dasive politike”: në vend se të mbyllet një kapitull historik, ajo në të vërtetë e hap problemin “nëse 19 prilli është tradhti ose zgjidhje e imponuar” (Antonić, 2013). Tema është ende tepër e freskët, ndërsa procesi është në vijim e sipër, por duket se ka sinjale të mjaftueshme për të përfunduar se, përkundër apo falë Marrëveshjes së Brukselit, në fuqinë e dytë dhe kushedi për të satën herë, vërtet po ndodh pak a shumë ndarja e njëjtë që edhe gjer më tani e ka prekur opinionin publik serb, tani vetëm me vija fronti edhe më të paqarta, në konfrontimin kronik të intelektualëve të brengosur për gjendjen e bashkësisë së vet. E sigurt duket vetëm një gjë: çështja e pazgjidhur fatalisht e Kosovës, e cila – vetëm në shikim të parë në mënyrë paradoksale – është në gjurmim të pandërprerë të zgjidhjes (përfundimtare) që do të vendosë fatin e saj, është larg prej të hequrit nga rendi i (për)ditës në elaboratet dhe komentet intelektuale, apo edhe të llojeve të ngjashme me to.

Literatura:

ANONIM (1999) „Rekli su 1989“, *Vreme*, br. 454, 18. shtator, gjendet në: http://www.vreme.com/arhiva_html/454/11.html (e parë më 15. shkurt 2015).

ANONIM (2004a) „Bečković: kosovski pepeo najskuplji pepeo XXI veka“, *Kurir*, 20. mars, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/kurir/2004/3/20/1D1A26EDB82> (e parë më 3.04.2015)

ANONIM (2004b) „Srpski pepeo najskuplji“, *Večernje novosti*, 20. mars, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2004/3/20/4033> (e parë më 3.04.2015).

ANONIM (2004c) „Novaković uzor za Koštunicu“, *Večernje novosti*, 24. mars, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2004/3/24/4EC> (e parë më 13.12.2014).

ANONIM (2008a) „Dimitrijević: Ristivojeviću nedostaju argumenti“, *Danas*, 28 shkurt, në dispozicion në adresën në internet: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/danas/2008/2/28/C12573B50045> (e parë më 22.03.2015).

ANONIM (2008b) „Reagovanja srpskih intelektualaca na nezavisnost Kosova“, Radio televizija Vojvodine, 17 shkurt, gjendet në: http://www.rtv.rs/sr_lat/politika/reagovanja-srpskih-intelektualaca-na-nezavisnost-kosova_49712.html (e parë më 17.08.2014).

ANTONIĆ, S. (2008), „Identitet“, *Večernje novosti*, 18 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/18/C12> (e parë më 3.05.2015).

ANTONIĆ, S. (2013) „Sporazum izvan ustava“, *Danas*, 23 prill, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/danas/2013/4/23/C1257AE8003> (e parë më 17.08.2015).

BEČKOVIĆ, M. (1989) *Kosovo – najskuplja srpska reč*, Valjevo: „Glas crkve“, botimi në internet në dispozicion në adresën: <http://www.rastko.rs/kosovo/umetnost/mbeckovic-kosovo.html> (e parë më 8.08.2014).

BEZRADICA, Mikojan (2008) „Što ga manje imamo, Kosovo više volimo“, *Glas javnosti*, 20 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/glas-javnosti/2008/2/20/C12573> (e parë më 12.10.2014).

BLAGOVJEVIĆ, Ljiljana (2008) „Užasno“, *Večernje novosti*, 19 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/19/C12> (e parë më 3.12.2014).

CRNČEVIĆ, B. (2008a) „Handkeova istina o Kosovu“, *Glas javnosti*, 25 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/glas-javnosti/2008/2/25/C12573> (e parë më 4.08.2014).

CRNČEVIĆ, B. (2008b) „Nerazumno“, *Večernje novosti*, 18 shkurt, në dispozicion në adresën në internet: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/18/C12...>: (e parë më 3.03.2015).

CRNČEVIĆ, B. (2008c) „Sigurna noć i nesiguran dan“, *Glas javnosti*, 18 shkurt,

gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/glas-javnosti/2008/2/18/C12573...> (e parë më 14.03.2015).

ĆIRIĆ, Z. (2008) „Prljavo“, *Večernje novosti*, 21 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/21/C12> (e parë më 23.04.2015).

EJDUS, P. (2008) „Razočaran“, *Večernje novosti*, 18 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/18/C12> (e parë më 17.04.2015).

ERAKOVIĆ, M. (2008) „Nasilje nad Srbijom i pravom“, *Glas javnosti*, 21 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/glas-javnosti/2008/2/21/C12573...> (e parë më 29.03.2015).

ERIĆ, D. (2008) „Oteto je proketo“, *Večernje novosti*, 21 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/21/C12> (e parë më 26.03.2015).

FILA, T. (2008) „Mit“, *Večernje novosti*, 23 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/23/C12> (e parë më 2.05.2015).

HABJANOVIĆ-ĐUROVIĆ, L. (2008) „Ojađeno“, *Večernje novosti*, 25 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/25/C12> (e parë më 16.10.2014).

HRISTIĆ, Z. (2008) „Harmonija“, *Politika*, 29 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/politika/2008/2/29/C12573B500> (e parë më 17.01.2015).

IGNJATOVIĆ, S. (2008) „Naša povelja, naša tapija“, *Večernje novosti*, 26 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/26/C12> (e parë më 7.12.2014).

KOVAČ, K. (2008) „Ispaštanje“, *Večernje novosti*, 18 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/18/C12> (e parë më 30.11.2014).

KOVAČEVIĆ, B. (2008) „Loše“, 18 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/18/C12...> (e parë më 23.05.2015).

KRESTIĆ, V. (2008) „Bahato“, *Večernje novosti*, 19 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/19/C12> (e parë më 7.06.2015).

LAŠIĆ, L. (2008) „Sramota“, *Večernje novosti*, 20 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/20/C12> (e parë më 3.12.2015).

MARINKOVIĆ, C. (2008) „Bolno“, *Večernje novosti*, 18 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/18/C12> (e parë më 15.09.2015).

MIHAILOVIĆ, B. (2008a), „Ružan san“, *Večernje novosti*, 18 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/18/C12> (e parë më 20.11.2014).

MIHAILOVIĆ, D. (2008b) „Ne smemo se predati“, *Večernje novosti*, 20 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/20/C12> (e parë më 4.10.2014).

MILOSAVLJEVIĆ, M. (2008) „Otadžbina je iznad partija“, *Glas javnosti*, 21 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/glas-javnosti/2008/2/21/C12573> (e parë më 11.01.2015).

NIKOLIĆ, T. (2012) „Intelektualci, potrebni ste Kosovu!“, *Kurir*, 19 nëntor, gjendet në: <http://www.kurir.rs/nikolic-intelektualci-potrebni-ste-kosovu-clanak-516472> (e parë më 7.08.2014).

OGNJENOVIC, V. (2008) „Nepravda“, *Večernje novosti*, 22 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/22/C12...> (e parë më 30.10.2015).

OMČIKUS, P. (2008) „Okupacija“, *Večernje novosti*, 18 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/18/C12> (e parë më 3.04.2008).

PACIĆ, S. (2008) „Bruka“, *Večernje novosti*, 19 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/19/C12> (e parë më 3.03.2015).

PAVIČEVIĆ, B. (2008b) „Ljudi kao dokaz“, *Danas*, 20 shkurt, në dispozicion në adresën në internet: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/danas/2008/2/20/C12573B50045> (e parë më 1.09.2014).

PAVIČEVIĆ, B. (2008a) „Vruć krompir za evropske ruke“, *Politika*, 24 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/politika/2008/2/24/C12573B500>. (e parë më 7.05.2015).

POPOVIĆ, Ljuba (2008) „Šta Srbija treba da čini“, *NIN*, 21 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/nin/2008/2/21/C12573B50045C> (e parë më 11.07.2015).

RAKITIĆ, Slobodan (2008) „Nema ničeg tužnijeg“, *Večernje novosti*, 20 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/20/C12> (e parë më 12.11.2014).

RANĐOLEVIĆ, N. (2010) „Društvo u krizi i odgovornost intelektualne elite“, *Politika*, 20 tetor, gjendet në: <http://www.politika.rs/rubrike/Komentari/Drustvo-u-krizi-i-odgovornost-intelektualne-elite.lt.html10.2010> (e parë më 3.08.2014).

RISTIĆ, L. (2008) „Odbija“, *Večernje novosti*, 18 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/18/C12>. (e parë më 17.12.2014).

ROSIĆ, T. (2008) „Amerizam je savremeni fašizam“, *Večernje novosti*, 24 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/24/C12> (e parë më 23.10.2014).

RŠUMOVIĆ, L. (2008) „Bog vraća“, *Večernje novosti*, 19 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/19/C12> (e parë më 12.10.2015).

SAMARDŽIĆ, L. (2008) „Zavičaj“, *Večernje novosti*, 18 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/18/C12> (e parë më 22.03.2015).

SAVIĆ, B. D. (2008a) „Niko nije smeo da napravi ovakav užas!“, *Dnevnik*, 23 shkurt, në dispozicion në adresën në internet: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/dnevnik/2008/2/23/C12573B500> (e parë më 4.03.2015).

SAVIĆ, B. D. (2008b) „Priprema li se rat protiv unutrašnjih neprijatelja?“, *Dnevnik*, 24 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/dnevnik/2008/2/24/C12573B500> (e parë më 7 qershor 2015).

STIPČEVIĆ, N. (2008) „Evropa postala licemerna“, *Večernje novosti*, 24 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/24/C12> (e parë më 2 shkurt 2015).

STOJILJKOVIĆ, Z. (2008) „Razočaran“, *Večernje novosti*, 25 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/25/C12> (e parë më 12. 11.2014).

ŠOBAJIĆ, M. (2008) „Agresija“, *Večernje novosti*, 18 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/18/C12> (e parë më 13.05.2015).

ŠOTRA, Z. (2008) „Gorko“, *Večernje novosti*, 18 shkurt, në dipozicion në adresën në internet: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/18/C12> (e parë më 6.03.2015).

TREBJEŠANIN, Žarko (2008) „Trauma“, *Večernje novosti*, 22 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/22/C12...>. (e parë më 30.11.2014).

VASILJEVIĆ, M. (2008) „Gaženje“, *Večernje novosti*, 19 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/19/C12> (e parë më 11.01.2015).

VELMAR-JANKOVIĆ, S. (2008) „Odavno smo izgubili Kosovo“, *Večernje novosti*, 21 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/21/C12> (e parë më 9.01 2015).

VUČETIĆ, S. (2008a) „Dan posle“, *Blic*, 29 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/blic/2008/2/29/C12573B50045C> (e parë më 23.03.2015).

VUČETIĆ, Slobodan (2008b) „Srbija bez Kosova, a svet bez OUN“, *Blic*, 22 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/blic/2008/2/22/C12573B50045C> (e parë më 21.01.2015).

ZUBAC, Pero (2008) „Odoleti“, *Večernje novosti*, 20 shkurt, gjendet në: <http://www.arhiv.rs/novinska-clanak/vecernje-novosti/2008/2/20/C12> (e parë më 14.01.2015).

Përktheu: Anton Berishaj

Predrag Krstiq (Predrag Krstić)

Institute of Philosophy and Social Theory
University of Belgrade

Intellectual processing of “Kosovo”: Serbian receptions, resignations and reactions

Abstract:

The paper follows the reactions of Serbian professional, cultural and intellectual public on the developments in Kosovo and about Kosovo in the last three decades, focusing in particular on the period of its unilateral declaration of independence. The first part of the article expose emotional responses to the challenge that the events in Kosovo provoked. The central section is devoted to explanations or rationalizations that tend theoretically to interpret them, with special emphasis on two characteristic models of understanding of „Kosovo“: the “Gnostic” and the “critical” one. The conclusion suggests that the impenetrability of rival discursive systems and argumentative flows of an already predefined conflict does not provide the hope not only for reconciliation, but even for a responsible dialogue among them.

Keywords:

Kosovo, Serbian intellectuals, emotional reactions, Gnostic vision, critical understanding, role of intelligence.

